

UDHËZIM
Nr. 23, datë 26.9.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE
SPORTIT NR. 21, DATË 18.8.2016, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
GJIMNAZIT ME KOHË TË PJESSHME”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “a”, të nenit 26, germës “b”, të nenit 16, dhe pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 69 /2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Neni 3 në udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 18.8.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme”, ndryshon si vijon:

“Nxënësi që ka dëftesën e lirit, të fituar brenda vendit ose një dëftesë të njëvlershme me të, të fituar jashtë vendit dhe është mbi 18 vjeç ditën e fillimit të vitit shkollor, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla